



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

K.DH.SH.II.nr.1366/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, me gjyqtarin Krenar Berisha, ne çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike Sh.a, me seli ne Prishtinë Bulevardi “Bill Klinton” nr.5, ndaj debitorit “Gjemi” shpk, me seli ne fshatin Samadrexhë Therandë, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale te Kosovës – Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1780/2022 datës 26.07.2023, me datën 28.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET si e bazuar ankesa e kreditorit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike Sh.a, me seli ne Prishtinë Bulevardi “Bill Klinton” nr.5, NDRYSHOHET aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1780/2022 i datës 26.07.2023, dhe çështja gjykohet si në vijim:

REFUZOHET si i pabazuar prapësimi i debitorit “Gjemi” shpk, me seli ne fshatin Samadrexhë Therandë, i ushtruar kundër Urdhrit përmbarimor P.nr.441/21 datës 06.12.2021 i lejuar nga Përmbaruesja Private Saranda Kuçi dhe Mbetet në fuqi Urdhri përmbarimor P.nr.441/21 datës 06.12.2021, i lejuar nga Përmbaruesja Private Saranda Kuçi nga Suhareka.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale te Kosovës – Dhomat e Shkalles se Parë –Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.1780/2022 dt.26.07.2023, e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit “Gjemi” shpk, me seli ne fshatin Samadrexhë Therandë, ndërsa ka shfuqizuar Urdhrin Përmbarimor P.nr.441/2021 dt.06.12.2021, te lejuar nga Përmbaruesja Private Saranda Kuçi me seli ne Suharekë.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë kreditori, për shkak të vërtetimit të shkeljeve thelbësore te dispozitave te procedurës kontestimore dhe përmbarimore, vërtetimit gabuar dhe jo te plotë te gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim qe gjykata e shkallës se dytë, këtë ankesë ta aprovoj si te bazuar, ta ndryshoj aktvendimin e atakuar, ose ta prish, dhe çështjen ta kthej ne rishqyrtim dhe rivendosje.

Dhomat e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbaremore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike Sh.a (KESCO), me seli ne Prishtinë Bulevardi “Bill Klinton” nr.5, me datën 06.12.2021, ka paraqitur propozim për përmbareme ndaj debitorit Gjemi” shpk J.M.V., me seli ne fshatin Samadrexhë Therandë, në bazë të dokumentit të besueshëm - Ekstraktit te verifikuar nga librat afarist te kontabilitetit- nen shifrën e konsumatorit DPZ .... Përmbareuesja Private Saranda Kuçi nga Suhareka, sipas propozimit te kreditorit, me urdhrin përmbareme P.nr.441/21 dt.06.12.2021, ka lejuar përmbaremin, me të cilën detyrohet debitori që kreditorit në emër konsumit te energjisë elektrike, t’ia paguaj shumën prej 20,187.86 euro, për periudhën kohore prej 01.08.2021 deri me datën 16.11.2021, dhe atë ne afat prej 7 ditësh, me kamatë prej 8% nga dita e kalimit te afatit për pagesë e deri ne pagesën definitive.

Kundër urdhrin përmbareme debitori ka paraqitur prapësim me datë 14.12.2021, me pretendimin se kreditori gabimisht e ngarkon me këtë shumë sepse nuk ka mundësi qe për një periudhë kaq te shkurtër te harxhoj këtë shumë. Propozimi për përmbareme është i papërshtatshëm për përmbareme sepse fare nuk përputhet me provat apo transaksionet e konsumatorit, propozon qe gjykata te caktoj seancë dëgjimore, propozon qe gjykata ta pranoj ne tërësi prapësimin e debitorit dhe kërkesa e kreditorit te refuzohet si e pabazuar ndërsa urdhri i përmbaremesit te lihet jashtë fuqie.

Përgjigje ne prapësim ka paraqitur kreditori me datën 15.12.2021, me arsyetimin se pretendimet e debitorit ne prapësim nuk qëndrojnë, propozimi për përmbareme është ne përputhje me nenin 29 dhe nenin 40 përfshirë nenin 341 te LPP. Prapësimi nuk është ne harmoni me nenin 69 te LPP, andaj konsideron se kundërshtimi i debitori është i paargumentuar, andaj propozon qe gjykata urdhrin përmbareme ta lë ën fuqi.

Gjykata Komerciale e Kosovës- Dhomat e Shkallës së parë, pas vlerësimit të prapësimit dhe përgjigjes në prapësim, ka nxjerrë aktvendimin KPPP.nr.1780/22 dt.26.07.2023, me të cilin ka vendosur decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar. Arsyeton se propozimi për përmbaremin përmban emrin e debitorit Gjemi shpk J.M.V., Samadrexhë –Therandë me numër te konsumatorit DPZ ..., me tej arsyeton se nga shkresat e lendes nuk rrjedh se përmbareuesi e ka ftuar kreditorin qe para se ta nxjerr urdhrin te beje korrigjim ose plotësim ne propozimin për përmbareme ashtu siç rregullohet me nenin 38 par.1 dhe 2 te LPP. Gjykata ne rastin konkret i referohet edhe nenit 43 par.4 te LPP dhe vlerëson se pasi mungesat ne propozimin për përmbareme paraqesin pengesa te pakapërcyeshme ligjore për këtë shkak gjykata vlerëson se urdhri përmbareme duhet te shfuqizohet. Gjykata analizon edhe pretendimet e palëve por gjeti se ne këtë

fazë për shkak të metave të gjetura nuk i ka shqyrtuar, andaj edhe ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit të saj.

Nisur nga një gjendje e tillë faktike e çështjes, Gjykata Komerciale –Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se nuk mund ta pranojë përfundimin dhe qëndrimin juridik të dhomës së shkallës së parë pasi gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të gabuar ashtu që edhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të gabuar, prandaj Dhoma e Shkallës së Dytë ka vendosur që ta ndryshoj aktvendimin e dhomës së shkallës së parë.

Në këtë rast dhoma e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar dispozitën e nenit 38 par.1 dhe 2, 43 par.4 dhe nenin 37 par.1 të LPP-së, të cilat i ka përdorë si bazë që të aprovohet si i bazuar prapësimi i debitorit i ushtruar kundër urdhrin për lejimin e përmbarimit, kjo pasi që nuk janë dhënë vlerësime në përputhje me dispozitat ligjore dhe gjendjen faktike mbi atë çka përmbajnë shkresat në lëndë, e mbi të cilën mund të iniciohet procedura e përmbarimit.

Gjykata Komerciale –Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerëson se dokumenti i besueshëm - Kartela Financiare e Konsumatorit me shifër DPZ ..., në bazë të së cilës është iniciuar procedura përmbarimore, është dokument përmbarues dhe i përshtatshëm për përmbarim, për faktin se kartela financiare e konsumatorit është lëshuar për periudhën 06.12.2021 mbi bazën e të cilës është lejuar përmbarimi është dokument i besueshëm, i vlefshëm juridikisht dhe i përshtatshëm për përmbarim, si dhe i plotëson kushtet ligjore nga neni 29 paragrafi 1 pika 1.2 dhe 1.3, 1.4 të LPP-së, që parashohin:

*Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është: ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave; 1.4. dokumentet që sipas dispozitave ligjore të posaçme kanë rëndësinë e dokumenteve publike;*

Dhoma e shkallës së Dytë analizon shkresat dhe provat në lëndë dhe vlerëson se propozimi për përmbarim është i përshtatshëm për përmbarim sepse nga kreditori është lëshuar në pajtim me dispozitat ligjore përkatësisht nenin 38 par.1 të LPP i cili parasheh që “Propozimi për përmbarim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbarim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbarimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbarimi, kërkuesi i përmbarimit dhe debitori, adresa e vendbanimit – vendqëndrimit apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjeti nëpërmjet cilit duhet kryer përmbarimi, objekti i përmbarimit po që se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbarimit” dhe par.2 i këtij neni i cili përcakton se “Në rast se propozimi për përmbarim nga paragrafi 1 i këtij neni nuk përmban shënimet e kërkuara dhe numrin personal identifikues apo numrin e regjistrimit të biznesit të debitorit, organi përmbarues do të veprojë sipas dispozitave të nenit 102 të Ligjit të Procedurës Kontestimore”, prandaj bazuar

ne këto dispozita ligjore dhe shkresave ne lëndë kjo gjykatë vlerëson se kreditori në propozim ka paraqitur te dhëna te mjaftueshme për identifikim te debitorit e nder to edhe numrin personal 1174141912, nga i cili numër rezulton qartë se kush është debitor ne rastin konkret, prandaj kjo gjykatë vlerëson se ushtrimi i propozimit për përmbarim përmbush prezumimet ligjore për lejimin e përmbarimit.

Nga këto arsye, Gjykata Komerciale –Dhomat e Shkallës së Dytë vlerëson ndryshe gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale dhe gjen se në rastin konkret plotësohen kushtet ligjore qe aktvendimi i ankimuar të ndryshohet, të refuzohet prapësimi i debitorit si i pa bazuar dhe të mbetet në fuqi Urdhri përmbarimor P.nr.441/21 dt.06.12.2021, i lejuar nga Përmbaruesja Private Saranda Kuçi. Dhomat e shkallës së dytë nuk mund ta pranoj qëndrimin e dhomës së shkallës së parë, e cila në arsyetim të aktvendimit konteston përmbajtjen e propozimit për përmbarim me arsyetimin se mungon numri i biznesit te debitorit dhe për këtë arsye edhe shfuqizon urdhrin përmbarimor duke iu referuar nenit 43 par.4 te LPP. Kjo gjykatë ne lidhje me këtë fakt nuk mund ta pranoj përfundimin juridik te gjykatës se shkallës se parë referuar këtij neni sepse nuk janë plotësuar prezumimet ligjore për te vepruar konform kësaj dispozite sepse ne propozim ka te dhëna te mjaftueshëm për identifikim te palës debitore ashtu qe janë plotësuar kushtet ligjore për nxjerrjen e urdhrin përmbarimor.

Nëse pala debitore për çfarëdo rrethane apo arsye pretendon se pala kreditore kërkon përmbarimin e detyrimit pa bazë ligjore, si shkak i të cilave palës debitore eventualisht ka mundur ti shkaktohet apo mund ti shkaktohet çfarëdo lloji dëmi më rastin e kryerjes se përmbarimit sipas kësaj lënde, nuk ka pengesa ligjore që lidhur më këtë të drejtën e tij ta realizoj në kontest të rregullt civil pranë gjykatës kompetente, ngase një pretendim i tillë i tij, nuk paraqet bazë ligjore për ndaljen, pezullimin apo përfundimin e përmbarimit në këtë rast.

Kompetenca e Dhomës së shkallës së dytë, për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual në shkallë të dytë, bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 194, 208, 209 paragrafi 1 pika c) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,  
Dhomat e Shkalles se Dytë  
K.DH.SH.II nr.1366/23, me datë 28.05.2024

Gjyqtari,  
Krenar Berisha